



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 964/5 Prot.

Tiranë, më 10. 12 . 2021

V E N D I M

Nr. 234, datë 10. 12 . 2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 120 Regj., datë 23.06.2021, të subjektit ankues Z. F, kundër: subjektit privat Bar *“Le 5 Stelle”*², Sarandë dhe Bashkisë Sarandë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të *“aftësisë së kufizuar”*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në deklaratimet dhe dokumentacionin bashkëlidhur ankesës, rezulton se, subjekti ankues, Z. F⁴, në vitin 2015 ka blerë një apartament nga kompania *“Noku-O-S-2008”* sh.p.k, në lagjen nr.1, Sarandë, sipas kushteve të rëna dakord dhe të nënshkruara nga të dyja palët, në Kontratën e Sipërmarrjes të datës 28.07.2015, përpara noterit Th. K.

Ankuesi citon se: *“Apartamenti është blerë në emër të Kompanisë “Jeta Jon AB” sh.p.k, (Kompania) me seli në Orebo Jan Sweden, në të cilën ai është pronar me aksione 100%. Kjo Kompani ka si veprimtari menaxhimin e personave me aftësi të kufizuara dhe apartamenti është*

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Gjatë shqyrtimit të ankesës, subjekti ankues ka hequr dorë nga pretendimi për diskriminim nga ana e subjektit privat *“Le 5 Stelle”*, duke ia ngarkuar përgjegjësinë Bashkisë Sarandë, si organ përgjegjës dhe pretendon për diskriminim nga ana e Bashkisë.

³ Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD.

⁴ Bazuar në pasaportën e ankuesit dhe deklaratimet e tij, ai rezulton me shtetësi suedeze dhe origjinë nga Kosova.

blerë në emër të kësaj Kompanie, me qëllim që të bëhet promovimi i personave me aftësi të veçanta nga Suedia në Sarandë, për të kaluar pushimet në këtë qytet”.

Ankuesi në parashtrimet e tij, shprehet se, në momentin e blerjes së apartamentit dhe garazhit, kushtet e specifikuara sipas Kontratës së Sipërmarrjes kanë qenë të respektuara dhe të zbatuara. Në objektin e kësaj Kontrate, specifikohet se: *“Ashensori do të ketë përmasa minimale me hapje të derës 90 cm, me gjatësi 1,40 cm x 1,20 cm. Objekti do të ketë hyrje dhe nga vendi i parkimit për hyrje të personave me aftësi të kufizuar si dhe djathtas hyrjes kryesore, ku objekti ndodhet në nivelin e rrugës”.*

Z. F shprehet se: *“Deri në vitin 2018 ka qenë e ndërtuar një rampë në krahun e djathtë të portës hyrëse në pallat, e cila shfrytëzohej nga ana ime për të shkuar në apartament. Kur erdha në muajin qershor 2021, rampa ishte hequr nga personi që zotëron një biznes privat në katin e parë të ndërtesës. Personi që zotëron këtë biznes, Bar “Le 5 Stelle”, ka prishur pjesën e rampës duke marrë gjysmën e ballkonit që ka qenë si shesh pushimi dhe e ka ndërtuar me shkallë, gjë që bën të pamundur lëvizshmërinë time si invalid (me karrocë) që jam”.*

Nëpërmjet shkresës me nr. 1131 prot., datë 11.06.2021, ankuesi i është drejtuar Bashkisë Sarandë, duke i kërkuar që të marrë masa për detyrimin e pronarit të lokalit për rindërtimin e rampës, pasi zgjerimi i ambjentëve të biznesit të tij, ka cënuar hapësirën e përbashkët në të cilën ishte e vendosur rampa dhe në këto kushte ai e ka të pamundur të aksesojë banesën e tij.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të marrë masa për ndalimin e diskriminimit të tij, duke detyruar subjektin privat Bar “Le 5 Stelle” dhe Bashkinë Sarandë, të marrin masa për rivendosjen e rampës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Bazuar në të dhënat e dokumentit të identifikimit të subjektit ankues, (pasaportës me numër personal 740206-2819 dhe kod SWE) rezulton se ai është me shtetësi të huaj, suedeze.

Përsa i takon legjitimitetit të subjektit ankues, për paraqitjen e ankesës pranë KMD-së, Komisioneri, vlerëson se:

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se:

“1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”.....”.

Bazuar në nenin 4, pika 3, të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet se:

“Ky ligj zbatohet për të gjithë personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.”

Bazuar në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

““Palë” është:

a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;
Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Referuar nenit 33, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

“1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person:

- a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative;
- b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative;
- c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.....”.

Bazuar në këto dispozita ligjore, ankuesi Z. F, në cilësinë e personit fizik, me shtetësi të huaj, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi, kundër Bashkisë Sarandë.

Shkaku i pretenduar nga ankuesi “aftësia e kufizuar”, është shkak i mbrojtur nga neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se:

“2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup

tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:

a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;3. Ndalohet për një person fizik ose juridik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, të mos pranojë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfitimin e këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuar ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet. 4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohet asnjë arsye si shkak i refuzimit”.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet me nr. 964/1 prot., datë 29.06.2021 Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime Bashkisë Sarandë, dhe subjektit privat, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
2. Duke mos patur përgjigje nga ana e Bashkisë, nëpërmjet shkresës me nr. 964/2 prot., datë 04.08.2021, Komisioneri ka kërkuar sërish parashtrime dhe kopje të dokumentacionit provues, të cituar në shkresën me nr. 964/1 prot., datë 29.06.2021, të tij.

- Njëpërmjet shkresës me nr. 3968/1 prot., datë 17.08.2021, Bashkia Sarandë, ka njohur Komisionerin lidhur me qëndrimin e saj për çështjen në fjalë, duke cituar ndër të tjera, se:

“...nga ana e Policisë Bashkiake Sarandë, është mundësuar verifikimi në terren i kësaj situate të përcjellë njëpërmjet ankesës së Z. F, nga ku është konstatuar se fizikisht në portën hyrëse të pallatit nuk ekzistonte asnjë rampë e ndërtuar. Nga ana jonë ka qenë e pamundur të verifikohet se kush ka qenë subjekti i cili e ka hequr rampën e pretenduar nga ankuesi, dhe për këtë arsye, pas vendosjes së kontaktit me banorë të tjerë të pallatit, jemi informuar se nuk kishte një administrator të zgjedhur nga ana e tyre si përfaqësues të banorëve të këtij objekti. Ndodhur në këto kushte, nga ana e Bashkisë Sarandë do të merren të gjitha masat për njoftimin e investitorit “NOKU-O-S-2008” sh.p.k me qëllim ndërhyrjen për zgjidhjen e kësaj problematike sipas dispozitave ligjore në fuqi”.

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, njëpërmjet shkresës me nr. 964/3 prot., datë 30.08.2021, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Komisioneri ka kërkuar paraprakisht nga ana e Bashkisë, të sqarojë gjatë seancës pikat e mëposhtme:

- Të evidentojë specifikisht se cilat janë masat konkrete (kopje të dokumentacionit provues), të ndërmarra, bazuar në kompetencat e Bashkisë, për zgjidhjen e problematikës së subjektit ankues.
- Në çfarë faze të shqyrtimit të problematikës ndodhet aktualisht çështja?
- Sa ëshë periudha kohore që i duhet Bashkisë për të zgjidhur përfundimisht këtë problematikë të ankuesit? (*Bazuar në citimin e shkresës me nr. 3968/1 prot., datë 17.08.2021, të Bashkisë Sarandë*).

Seanca u zhvillua me datë 23.09.2021, në mungesë të subjektit ankues, dhe në praninë e përfaqësuesit të Bashkisë Sarandë, A. B⁵, i cili u qëndroi të njëjtave parashtrime që Bashkia kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, duke shtuar se:

“Nga ana e Policisë Bashkiake të Bashkisë Sarandë është mundësuar verifikimi në terren⁶ i kësaj situate të përcjellë njëpërmjet ankesës së Z. F, nga ku është konstatuar se fizikisht në portën hyrëse të pallatit nuk ekzistonte asnjë rampë e ndërtuar. Nga ana jonë ka qenë e pamundur të verifikohet se kush ka qenë subjekti që ka hequr rampën e pretenduar nga ankuesi, dhe për këtë arsye pas vendosjes së kontaktit me banorët e tjerë të pallatit, jemi informuar se nuk kishte një administrator të zgjedhur nga ana e tyre si përfaqësues të banorëve të këtij objekti.

Ndodhur në këto kushte, nga ana e Bashkisë janë bërë të gjitha përpjekjet për të vendosur një mundësi kontakti me investitorin e këtij objekti, shoqërinë “Noku-O-S-2008” sh.p.k., me qëllim ndërhyrjen për zgjidhjen e kësaj problematike.

⁵ Bazuar në Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Sarandë, më datë 21.09.2021.

⁶ Referuar Raportit të Shërbimit, datë 07.08.2021, ora 10:00, të Njësisë së Shërbimit pranë Policisë Bashkiake.

Në pamundësi për të vendosur një kontakt me këtë subjekt, orientojmë ankuesin për të aplikuar për pajisjen me lejen përkatëse, me qëllim kryerjen e punimeve për ndërtimin e rampës për të cilën ai ka nevojë”.

Përfaqësuesi i Bashkisë u njoh me fotot e sjella nga ankuesi, dhe pretendimin e tij lidhur me dokumentimin e ekzistencës së rampës deri në vitin 2018, dhe pas këtij viti (bazuar tek pamjet fotografike) “zhdukjen” e saj dhe pamje me hapësira të zgjeruara të lokalit.

Atij iu bë e njohur e drejta për të sjellë parashtrime dhe dokumentacion shtesë në vijim, lidhur me këto pretendime të ankuesit.

Në vijim, nuk u sollën argumente apo dokumentacion shtesë nga ana e Bashkisë.

Nga ana e ankuesit, nëpërmjet e-mailit datë 16.11.2021, Komisioneri është informuar se ai heq dorë nga pretendimi për diskriminim nga ana e subjektit privat “Le 5 Stelle”, pasi konsideron si institucion përgjegjës për diskriminimin ndaj tij, Bashkinë Sarandë e cila duhet të merrte masat për zgjidhjen e problematikës së tij. Ankuesi ka kërkuar konstatimin e diskriminimit vetëm nga kjo e fundit dhe ndreqjen e pasojave prej saj, duke mundësuar ndërtimin e rampës.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjektet ankues janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas/individë të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”.

Mirëpo, në kushtet kur ky “krahasues” mungon, vlerësohet nëse ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë në raport me parashikimet ligjore.

Në kontekst të legjitimitetit të subjektit ankues kundrejt subjektit ndaj të cilit ka pretenduar diskriminimin, Komisioneri vëren se, bazuar në kompetencat e sanksionuara nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Bashkia Sarandë gëzon legjitimitet pasiv në këtë proces, pasi ka tagrin për ushtrimin e funksioneve të saj në interes publik, duke i shtrirë kompetencat e saj vetëm në ato hapësira, të cilat ndodhen nën juridiksionin përkatës dhe nën administrimin e saj, siç është edhe rasti i objektit/pallatit, ku ndodhet banesa e poseduar nga ankuesi.

Në këtë kontekst, Komisioneri, do të marrë në shqyrtim pretendimin e ankuesit, lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm të tij nga ana e Bashkisë Sarandë, përfshirë të gjitha strukturat përkatëse në varësi të saj.

A.1 Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, se është trajtuar në mënyrë të padrejtë, e të pafavorshme nga ana e Bashkisë Sarandë, përse i takon mosveprimit të saj për zgjidhjen e problematikës së aksesueshmërisë në banesën e tij.

Bazuar në analizimin e dokumentacionit, fakteve e kronologjinë e ngjarjeve, rezulton se:

Subjekti ankues, Z. F, me numër personal ID 740206-2819, është me shtetësi të huaj, suedeze.

Sipas Kontratës së Sipërmarrjes të datës 28.07.2015, Z. F (*Porositësi*), ka blerë një apartament nga kompania “Noku-O-S-2008” sh.p.k. (*Investitori*), në lagjen nr. 1, Sarandë, sipas kushteve të rëna dakord dhe të nënshkruara nga të dyja palët, në këtë kontratë.

Në objektin e kësaj Kontrate, specifikohet se: “*Ashensori do të ketë përmasa minimale me hapje të derës 90 cm, me gjatësi 1,40 cm x 1,20 cm. Objekti do të ketë hyrje dhe nga vendi i parkimit për hyrje të personave me aftësi të kufizuar si dhe djathtas hyrjes kryesore, ku objekti ndodhet në nivelin e rrugës*”.

Ankuesi është shprehur se në momentin e blerjes së apartamentit/banesës së tij, në vitin 2015 e deri në vitin 2018, ka qenë e ndërtuar një rampë në krahun e djathtë të portës hyrëse në pallat, e cila shfrytëzohej prej tij për të shkuar në apartament, ndërsa në muajin qershor 2021, ka konstatuar se rampa ishte hequr nga personi që zotëron një biznes privat në katin e parë të ndërtesës. Ai ka pretenduar se personi që zotëron këtë biznes, Bar “Le 5 Stelle”, ka prishur pjesën e rampës duke marrë gjysmën e ballkonit që ka qenë si shesh pushimi dhe e ka ndërtuar me shkallë, gjë që bën të pamundur lëvizshmërinë e tij si invalid (me karrocë me rrota).

Nëpërmjet shkresës me nr. 1131 prot., datë 11.06.2021, ankuesi i është drejtuar Bashkisë Sarandë, për adresimin e problematikës së tij, duke i kërkuar që të marrë masa për detyrimin e pronarit të lokalit për rindërtimin e rampës, pasi zgjerimi i ambjenteve të biznesit të tij, ka çënuar hapësirën e përbashkët në të cilën ishte e vendosur rampa dhe në këto kushte ai e ka të pamundur të aksesojë banesën e tij.

Pretendimet e ankuesit kundrejt Bashkisë lidhen me mosveprimin e kësaj të fundit, lidhur me masat që duhej të ndërmerre për zgjidhjen e dy problematikave të ngritura prej tij:

- Prishjen e rampës nga pronari i lokalit Bar “Le 5 Stelle”;
- Cënimin e hapësirës të përbashkët të pallatit ku më parë ishte e vendosur rampa, përmes zgjerimit të ambjenteve të lokalit, duke bllokuar kalimin dhe pamundësuar aksesin e ankuesit për në banesë.

Komisioneri, në analizë të sa më sipër, ka vlerësuar se:

- Bashkia Sarandë nuk ka vepruar në zbatim të kompetencave të saj ligjore, për marrjen e masave për verifikimin e pretendimit të ankuesit për cënim të hapësirës së përbashkët të pallatit, nga biznesi privat Bar “Le 5 Stelle”, duke marrë pjesë të konsiderueshme të verandës së përbashkët të pallatit.
- Bashkia nuk argumentoi, as dokumentoi se Bar “Le 5 Stelle”, ishte me dokumentacion të rregullt, të njohur e pranuar prej saj.
- Në kopjen e Raportit të Shërbimit, datë 07.08.2021, të Patrullës së Policisë Bashkiake Sarandë, evidentohet se është bërë verifikimi i pretendimit të subjektit ankues në terren,

vetëm përse i takon heqjes së rampës dhe është konstatuar se në hyrjen e pallatit nuk ekzistonte asnjë rampë.

- Nga këqyrja e Raport Shërbimit, nuk konstatohet të jetë evidentuar problematika e ngritur nga ankuesi lidhur me uzurpimin e hapësirës së përbashkët të pallatit, një pjesë të verandës së përbashkët, e cila ishte marrë nga subjekti privat Bar “Le 5 Stelle”, duke u përfshirë si pjesë e këtij lokali, dhe duke u shndërruar në pengesë për kalimin dhe aksesimin e ankuesit për tek ashensori dhe më pas në banesën e tij.
- Nga Patrulla e Policisë Bashkiake, nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e rastit nëse kishte ekzistuar më parë rampa, se ku kishte qenë e ndërtuar ajo, apo se nga kush mund të ishte prishur. (Nëse kishte qenë e ndërtuar aty ku sipas ankuesit ishte zgjeruar lokali).
- Nuk evidentohet në këtë Raport Shërbimi të jetë kontaktuar, pyetur apo marrë informacion nga ndonjë përfaqësues i lokalit “Le 5 Stelle”.
- Nga Bashkia Sarandë nuk është kundërshtuar pretendimi i ankuesit mbi faktin se një pjesë e lokalit “Le 5 Stelle” shtrihet në verandën e pallatit ku banon ai, sipërfaqja e të cilës ndodhet në bashkëpronësi të gjithë banorëve të pallatit, gjë e cila ka penguar lëvizjen e ankuesit për të kaluar në banesën e tij, duke hamendësuar se kjo shtesë ishte ndërtim i paligjshëm.
- Nuk rezulton të jetë verifikuar, provuar a dokumentuar e kundërta e këtij pretendimi nga ana e Bashkisë. Bashkia nuk është shprehur fare lidhur me faktin nëse shtesa e lokali, që ankuesi ka pretenduar se ka uzurpuar ambjentet e përbashkëta të pallatit, është ndërtim i ligjshëm apo jo.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 23, pika 14, e tij, ka përcaktuar, ndër të tjera, se:

“Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

.....

14. Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.

Lidhur me verifikimin e këtij fakti, Komisioneri vlerëson se ishte detyrë e Inspektoriatit për Mbrojtjen e Territorit (IMT), pranë Bashkisë Sarandë, (si pjesë përbërëse e Bashkisë), i cili ushtron veprimtarinë dhe kompetencat e tij, bazuar në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriat i Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Inspektoriat i Vendor i Mbrojtjes së Territorit”.

Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit ka si mision të punës së tij:

-Të mbajë nën kontroll territorin urban të Bashkisë, në funksion të zbatimit të planit rregullues të qytetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

-Të ndërhyjë në të gjitha rastet kur vëren shkelje të ligjit për urbansitikën dhe të ndalojë e më pas të vendosë për prishjen e çdo ndërtimi pa leje dhe në kundërshtim me planin e përgjithshëm rregullues të qytetit.

Bazuar në legjislacionin sa më sipër, detyrat kryesore funksionale të Kryeinspektorit dhe inspektorit të IMT/Bashkia Sarandë, janë respektivisht, ndër të tjera:

Kryeinspektori:

- Të organizojë dhe drejtojë të gjithë veprimtarinë e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Sarandë dhe njësitë administrative, për të cilën raporton tek Drejtori i Policisë, Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit.
- Ndjek zbatimin e detyrave që dalin nga aktet ligjore dhe nënligjore në veprimtarinë e IVMT-së;
- Shqyrton dhe merr vendime për shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit të zbatimit të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit;
- Vendos masa administrative në ngarkim të subjekteve që shkelin ligjshmërinë në fushën e ndërtimit, siç parashikohet në aktet ligjore në fuqi;
- Përgatit kallëzim penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;
- Vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;
- Në zbatim të detyrimeve ligjore kërkon zyrtarisht mbështetjen e strukturave të Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake, për zbatimin e vendimeve për prishje të objekteve të kundërligjshme.

Inspektori, i cili është nëpunës, me varësi direkte nga Kryeinspektori, ka këto detyra:

- Ushtron funksionet ligjore brenda kufijve territorialë të Bashkisë Sarandë;
- Ushtron kontroll në gjithë territorin e Bashkisë, veçanërisht tek subjektet e ndërtimit, sipas planit të miratuar më parë nga Kryeinspektori, sipas kësaj procedure:
- I paraqet subjektit njoftimin për kontroll, nënshkruar nga Kryeinspektori;
- Mbas shtatë ditësh nga data e kontrollit mban aktin e kontrollit për problematikat e konstatuara në subjekt, në të cilin përcaktohet afati 10 ditë për realizimin e detyrave të lëna;
- Në rast të mosrealizimit të detyrimeve ligjore të lëna në akt-kontroll, subjekti mban përgjegjësi, ndërsa inspektori plotëson aktin e konstatimit;
- Merr pjesë në ekzekutimin e gjithë vendimeve për prishje të objekteve të paligjshme brenda territorit të Bashkisë;
- Pasqyron veprimtarinë e punës në procesverbalin e konstatimit, të cilin ia dorëzon Kryeinspektorit;
- Vlerëson konfliktet sociale gjatë ndërtimit, ankesa këto të ardhura me shkrim nga subjekte fizike apo juridike (private e shtetërore) dhe jep mendime për mënyrën e zgjidhjes ligjore;
- Ndjek dhe zbaton urdhërat dhe detyrat e dhëna nga Kryeinspektori gjatë ushtrimit të kontrolleve;
- Dokumenton punën e bërë në ushtrimin e detyrës me aktet proceduriale të miratuara;

Nga ana tjetër, Komisioneri vlerëson se, argumenti i Bashkisë se mungesa e administratorit të zgjedhur për përfaqësimin e banorëve të këtij pallati, bëri që të mos evidentohet se cili ishte

subjekti që kishte hequr, prishur rampën, nuk qëndron dhe është i pabazuar. Kjo pasi, ankuesi, në mungesë të administratorit të pallatit kishte paraqitur ankesën e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe konkrete, kundrejt Bashkisë.

Neni 19⁷, i ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, ka përcaktuar detyrimin e Bashkisë për të marrë në shqyrtim ankesat e çdo qytetari të saj, duke parashikuar se:

“1. Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t’u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetë-qeverisjes vendore.

2. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t’i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj”.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, bashkitë kanë kompetenca konkrete në përmbushjen e funksioneve publike në interes të komunitetit që përfaqësojnë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Sipas këtij Ligji, bashkitë veprojnë dhe i ushtrojnë funksionet e tyre në interes publik dhe këto kompetenca shtrihen vetëm në ato hapësira, të cilat ndodhen nën juridiksionin e tyre përkatës dhe nën administrimin e tyre publik.

Gjithashtu, në pikën 1, të nenit 8⁸, të ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”* parashikohet: *“Organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor në territorin e juridiksionit të tyre për çdo çështje që nuk u ndalohej me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror.”*

Në kuptim dhe zbatim të parashikimeve të mësipërme, rezulton se Bashkia vepron vetëm në ato hapësira që janë publike dhe brenda kompetencave që këtij institucioni i atribuohen nga dispozitat ligjore përkatëse.

Ligji *“Për vetëqeverisjen vendore”*, ka përcaktuar se, njësitë e vetëqeverisjes vendore gëzojnë dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi.

Në këtë kontekst, për të patur një panoramë sa më të qartë të çështjes në shqyrtim, si dhe për të evidentuar rolin dhe kompetencat që ka Bashkia Sarandë në rastin konkret, Komisioneri mori në analizim dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 *“Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar (në vijim, Kodi Civil), ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009 *“Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”* dhe Vendimit nr. 447, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”*.

⁷ “E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes”.

⁸ “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor”.

Në Kreun II/A, përkatësisht në nenet vijuese 209–221, të Kodi Civil përcaktohet “Bashkëpronësia e Detyrueshme” dhe më specifikisht mbi objektet e përbashkëta të ndërtesave.

Në nenin 209, të Kodit Civil parashikohet shprehimisht:

“Në katet ose njësitë e ndara të kateve të një ndërtese që ndodhen në pronësi të veçantë të pronarëve të ndryshëm, janë në bashkëpronësi të detyrueshme të tyre, gjersa në aktin e pronësisë nuk është caktuar ndryshe, këto objekte:

a) trualli mbi të cilin është ngritur ndërtesa, themelet, muret kryesore, muret ndarëse të brendshme, shkallët, hollet, çatia ose taraca, oxhaqet, si edhe të gjitha ato objekte të ndërtesës, që kanë karakter të tillë dhe shërbejnë për përdorim të përbashkët;

Në referencë të neneve 210-211 të Kodit Civil, e drejta e secilit bashkëpronar mbi sendet e përmendura në nenin e mësipërm, është në përpjesëtim me vleftën e katit ose të pjesëve të katit që i përkasin atij, përveç kur titulli parashikon ndryshe. Heqia dorë nga e drejta mbi sendet e mësipërme, nuk e liron bashkëpronarin nga detyrimi për të kontribuar në shpenzimet përmbajtjen e tyre. Objektet e përbashkëta të ndërtesës nuk lejohet të ndahen, përveç kur ndarja e ndonjërit prej tyre mund të kryhet pa ia vështirësuar përdorimin e tij asnjërit nga bashkëpronarët.

Në nenin 212 të Kodit Civil parashikohet krijimi i Asamblesë së bashkëpronarëve të ndërtesës dhe kryesisë së saj, duke përcaktuar edhe kompetencat e saj. Kryesia ngarkohet të kryejë, në emër e për llogari të tyre të gjitha veprimet e nevojshme për administrimin dhe mirëmbajtjen e zakonshme të objekteve të përbashkëta, përveç atyre veprimeve që janë në kompetencë vetëm të asamblesë, si dhe të përfaqësorë në instancat gjyqësore kompetente dhe në arbitrazh.

Neni 212 e vijues përcaktojnë përbërjen e Asamblesë, zgjedhjen e kryesisë dhe kompetencat e Asamblesë⁹, e cila ka funksione të mirëpërcaktuara në drejtim të administrimit të ndërtesës dhe ambienteve të përbashkëta.

Në rastin konkret, rezulton se Asambleja e pallatit ku banon ankuesi, nuk funksionon, pasi nga informacioni e faktet e administruara rezulton se nuk ekziston një e tillë, po ashtu, as një administrator i cili mund të përfaqësonte pranë Bashkisë, interesat e banorëve apo mbikëqyrur detyrimet e tyre. *(Emërimi i administratorit të pallatit është një parashikim ligjor i përcaktuar edhe në aktet rregullatore të funksionimit të njërive të vetëqeverisjes vendore, bashkive, çka do të analizohet në vijim të vendimit).*

⁹ Asambleja ka edhe këto kompetenca kryesore: Miraton rregulloren për administrimin e banesës, e cila hartohet sipas rregullores tip të miratuar nga Këshilli i Ministrave; Krijon fondin rezervë për shpenzimet e përbashkëta, duke caktuar edhe shumën vjetore të tij; Miraton preventivat e shpenzimeve që ka vendosur të kryhen gjatë vitit, si dhe ndarjen e shumës së tyre midis bashkëpronarëve. Shpenzimet e përbashkëta për mirëmbajtjen, riparimet dhe përmirësimet e zakonshme të këtyre objekteve miratohen nga asambleja me shumicë të thjeshtë votash, ndërsa shpenzimet për përmirësime të mëdha ose rinësime cilësore vendosen me shumicë të cilësuar të bashkëpronarëve që arrijnë të paktën 75% të kuotave përkatëse; Emëron, kur çmohet e domosdoshme, kujdestarin e ndërtesës, duke caktuar kompetencat dhe pagën e tij; Autorizon kryesinë që të sigurojë, brenda kufijve të arsyeshme, objektet që janë pronë e përbashkët, si dhe të lidhë kontrata të tjera të nevojshme për mirëmbajtjen, riparimet dhe përmirësimet e zakonshme, ose, sipas rastit, për përmirësime të mëdha apo rinësime të këtyre objekteve.

Neni 217, i Kodit Civil, përcakton detyrimet e bashkëpronarëve, që, ndër të tjera, konsistojnë:

“2. Të mos kryejë në katin ose njësinë e ndarjes së katit, që është në pronësi të veçantë të tij, ndërtime të cilat mund t’u shkaktojnë dëme objekteve të përbashkëta të ndërtesës. 3. Të ndreqë dëmin ose të paguajë shpenzimet për zëvendësimin e tij, që ai vetë ose një anëtar i familjes së tij i ka shkaktuar me faj, cilitdo objekti të përbashkët. 4. Të mos kryejë, pa lejen paraprake të asamblesë, në katin ose në njësinë e ndarë të katit që është në pronë të tij, shtesa ose ndryshime të cilat mund të çenojnë pamjen e jashtme të ndërtesës.”

Për sa më sipër, Kodi Civil përmban parashikime dhe rregulla të përgjithshme mbi bashkëpronësinë e detyrueshme, pa i atribuar kompetenca apo tagra specifike organeve të pushtetit vendor, ndërkohë që ligji nr. 10112, datë 9.4.2009 *“Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”* dhe Vendimi nr. 447, datë 16.06.2010, i Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”*, kanë përcaktime më të detajuara, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen objekt shqyrtimi.

Në nenin 6¹⁰ të ligjit nr. 10112, datë 09.04.2009 *“Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”* parashikohet: *“Në njësitë ku ka dy ose më shumë pronarë, marrëdhëniet e bashkëpronësisë ndërmjet pronarëve rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit Civil, të këtij ligji dhe të rregullores së administrimit të banesave”*.

Sikurse vihet re nga parashikimi i dispozitës së mësipërme, bashkëpronësia në ndërtesat e banimit rregullohet nga dispozitat e Kodit Civil, dispozitat rregulluese të ligjit nr. 10112, datë 09.04.2009 *“Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”*, si dhe të Vendimit nr. 447, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”*. Shkronja a), e nenit 9¹¹, të ligjit nr. 10112, datë 09.04.2009 *“Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”*, parashikon të drejtën e pronarit të njësisë të kërkojë nga bashkëpronarët e tjerë, në bashkëpronësinë e detyrueshme ku bën pjesë, apo dhe nga përdoruesit e këtyre njësive të veçanta, të mos e çenojnë përdorimin dhe gëzimin e objekteve të pandashme, si dhe të kërkojë dëmshpërblim apo ndreqje të dëmit, kur dëmi është shkaktuar nga veprimet e tyre.

Shkronjat a) dhe b) të nenit 10, të ligjit të sipërpërmendur parashikojnë detyrimet e pronarit të njësisë, ku sipas parashikimit të këtij neni, pronari i njësisë ka detyrimet e mëposhtme:

“a) të respektojë normat e etikës dhe të bashkëjetesës, të përcaktuara në rregulloren e administrimit të ndërtesave;

b) të mos i pengojë bashkëpronarët e tjerë në gëzimin e objekteve, që janë në bashkëpronësi të detyrueshme. Në njësitë ku ka dy ose më shumë pronarë, marrëdhëniet e bashkëpronësisë ndërmjet pronarëve rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit Civil, të këtij ligji dhe të rregullores së administrimit të banesave”.

¹⁰ “Bashkëpronësia e njësive”

¹¹ “Të drejtat e pronarit të njësisë”

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se dispozita e mësipërme i njeh të drejtën ankuesit, sikurse edhe çdo individ tjetër në cilësinë e bashkëpronarit në ambientet e përbashkëta të pallatit ku banon, që të gëzojë në mënyrë të plotë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga pronësia mbi sendin, sikurse nuk lejon, nga ana tjetër, cënimin e kësaj të drejte nga bashkëpronarët apo përdoruesit e tjerë.

Ndërkohë që, zgjidhja e konflikteve ndërmjet bashkëpronarëve, në banesat ku ekziston bashkëpronësia, parashikohen shprehimisht në nenet 35-36, të Vendimit nr. 447, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”*, ku parashikohet shprehimisht, si vijon:

“1. Bashkëpronarët mundohen t'i zgjidhin konfliktet me mirëkuptim dhe kur nuk arrihet mirëkuptimi, sipas përkatësisë kryesia, administratori ose njëri prej bashkëpronarëve mund t'i drejtohet njërit prej organeve më poshtë:

- a) Policisë bashkisë/komunës për mosrespektim të normave detyruese sipas nenit 34, kreu VII;*
- b) Inspektoratit vendor ndërtimor urbanistik për ndërhyrje të pamiratuara në pjesët a objektet e pronës së përbashkët”.*

Për sa më sipër, Komisioneri konstaton se ligjvënësi ka parashikuar kompetenca të strukturave të organeve vendore, për të ndërhyrë në rastet e zgjidhjes së konflikteve ndërmjet bashkëpronarëve, në banesat ku ekziston bashkëpronësia e detyrueshme.

Referuar shkronjës f), të pikës 3, të nenit 34, të Kreu VII të VKM-së së sipërpërmendur parashikohet se:

“Zonat e përbashkëta brenda ose jashtë godinës së banimit, si shkallët, sheshpushimet, tarracat, verandat e përbashkëta, lulishtet dhe vendkalimet nuk do të përdoren për ruajtje, parkime ose të bllokohen”.

Njëkohësisht mbështetur në shkronjën d), të pikës 4, të nenit 34, të kreu VII të VKM-së së sipërpërmendur parashikohet se:

“Asnjë shërbim, aktivitet tregtie ose aktivitet e veprimtari e dëmshme ose fyese nuk do të kryhet brenda zonave të përbashkëta, dhe nuk do të kryhet asnjë veprim që mund të përbëjë shqetësim, bezdisje për fqinjësinë ose bashkëpronarët e tjerë”.

Në këtë kuptim, Bashkia Sarandë, si administratore e territorit të saj, duhej që edhe kryesisht të konstatonte, verifikonte e ndëshkonte, ndërhyrjet në pallatin ku ishte dhënë leja e ndërtimit dhe që me veprime të paligjshme kanë zaptuar prishur struktura ndërtimore (rampën) të cilat aksesoheshin për përdorim nga personat me aftësi të kufizuar, në rastin konkret nga ankuesi. Për rrjedhojë, pretendimi i Bashkisë, se ankuesi mund të aplikojë për t'u pajisur me leje për ndërtimin e rampës, është gati absurd dhe krejtësisht i pajustificuar, pasi leja për ndërtimin e rampës presupozohet dhe jepet sipas ligjit, njëherësh me lejen e ndërtimit të pallatit, si një kusht ligjor. Leja e ndërtimit të pallatit, nuk mund të jepej pa parashikuar elementët e veçantë ndërtimor që e bëjnë të përdorshëm e aksesueshëm atë edhe nga personat me aftësi të kufizuar.

Komisioneri gjykon se parashikimet e mësipërme janë drejtpërdrejtë të zbatueshme për rastin e subjektit ankues.

Pronari i lokalit “Le 5 Stelle” ushtron një aktivitet biznesi në një verandë pallati që ndodhet në bashkëpronësi, të tij me banorët e tjerë të pallatit. Ushtrimi i një aktiviteti të tillë ndalohej të kryhet në ambientet e përbashkëta, në kushtet kur ka sjellë shqetësim tek njëri prej bashkëpronarëve të kësaj verande/holli dhe atë më tepër ka sjellë si pasojë mos garantimin e aksesueshmërisë për në banesën e tij. Po ashtu, ngrihen dyshime të forta që për efekt të zgjerimit të sipërfaqes së lokalit, ai mund të ketë prishur edhe rampën ekzistuese, e cila ishte e ndërtuar dhe funksiononte deri para zgjerimit të hapësirave të lokalit.

Në rastin konkret, Komisioneri çmon se Bashkia Sarandë nuk ka marrë asnjë masë për të ndaluar pengesën e ankuesit, për të patur aksesueshmëri të plotë për në banesën e tij.

Komisioneri gjykon se në referencë të dispozitës së mësipërme, Bashkia Sarandë duhet të kishte marrë masat përkatëse për zgjidhjen e çështjes në fjalë, atë më tepër që ankuesi është ankuar me shkrim, pranë këtij institucioni.

Argumenti i Bashkisë lidhur me faktin që ankuesi mund të drejtohej në çdo kohë pranë gjykatës kompetente për zgjidhjen e çështjes, nuk justifikon mosveprimin nga ana e saj për marrjen e masave për një zgjidhje efektive të problemit të tij.

Nga analizimi i situatës, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, Komisioneri gjykon se subjekti ankues është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë e të pafavorshëm nga Bashkia Sarandë, e cila përmes mosveprimit të saj nuk ka marrë masa për zgjidhjen efektivisht të ankesës së Z. F, lidhur me realizimin e aksesueshmërisë së lëvizjes së tij për në banesë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹², të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ky ligj, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

¹²“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.

B/1 Aftësia e kufizuar

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohej vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Subjekti ankues, ka pretenduar diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Bazuar në dokumentin me të dhënat mjekësore të ankuesit, të Klinikës Neurologjike të Spitalit Universitar në Örebro, Suedi, rezulton që ai është diagnostikuar me: “Limb Girdle, distrofi muskulare e tipit 2A, (Calpainopati)”.

Dokumenti, ndër të tjera, citon se: “...Kjo sëmundje shkaktohet nga një ndryshim në gjenomin e Calpain duke shkaktuar dobësi muskulare, shkurtim të muskujve dhe tetinave, si dhe lëvizshmëri të kufizuar muskulare. Sëmundja shkakton dhe kapacitet të reduktuar të frymëmarrjes...duke dobësuar edhe diafragmën...”

Ai vuan nga sëmundja e distrofisë muskulare tipi 2A dhe për këtë arsye lëvizja e tij është e kushtëzuar vetëm nëpërmjet mjetit të posaçëm (karrocë me rrota).

Konventa e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara¹³”, në nenin 1 të saj, ka përcaktuar se: “Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët”.

¹³ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 108/2012.

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky shkak i pretenduar nga subjekti ankues konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se e mbart atë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar e dokumentuar shkakun e pretenduar të diskriminimit nga ana e ankuesit, atë të aftësisë së kufizuar.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Në pikën A.1 të Vendimit, Komisioneri, ka konstatuar se subjekti ankues është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë e të pafavorshëm nga Bashkia Sarandë, dhe se ajo, përmes mosveprimit të saj nuk ka marrë masa për zgjidhjen efektivisht të ankesës së tij, lidhur me aksesueshmërinë e lëvizjes së tij për në banesë.

Kushtetuta është akti më i lartë juridik, ligji më i lartë (lex superior), në pajtueshmëri me të cilin duhet të jenë të gjitha aktet e tjera juridike.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: “*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në thell të të gjithë rendit juridik*”. Neni 18, i saj shpreh se: “*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit*”.

Në nenin 59, shkronjat e) dhe f) të saj ka parshikuar se:

“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;

f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës”.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor¹⁴.

¹⁴¹⁴ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (*e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”*) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), në nenin 14 të saj, ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë joshteruese shkaqesh. Ndërkohë Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur subjekti është diskriminuar:

“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;

b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;

c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;

d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) siguron mbrojtje kundër diskriminimit në gëzimin e të drejtave të përcaktuara me ligj, si dhe afirmon ndalimin e diskriminimit nga ana e autoriteteve publike. Në interpretim të nenit të kësaj konvente, një person është i diskriminuar, për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 14 të KEDNJ-së, nëse nga sjellja (veprimi ose

mosveprimi) e autoriteteve shtetërore, i mohohet gëzimi i të drejtave, që legjislacioni kombëtar i njeh individëve në mënyrë specifike, të cilat rrjedhin nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik sipas legjislacionit kombëtar, nga një autoritet publik në ushtrimin e pushtetit diskrecional, si dhe nga çdo veprim ose mosveprim tjetër i një autoriteti publik. (*Shih Sejdic dhe Finci kundër Bosnjë-Hercegovinës* (2009); *Savez Crkava "Rijec Zivota" dhe të tjerët kundër Kroacisë nr. 7798/08, § 58, 9 dhjetor 2010*).

Shqipëria e ratifikoi Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, në Dhjetor të vitit 2012 dhe është bërë Palë në të, që prej 11 Shkurtit 2013.

Kjo Konventë, në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: *"Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar."*

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK), ka për qëllim të nxisë, mbrojtë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

Në kuptimin të kësaj Konvente: *"Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar"* ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës".

Parimet e kësaj Konvente përfshijnë:

- "(a) Respektin për dinjitetin, autonominë individuale përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit;*
- (b) Mosdiskriminimin;*
- (c) Pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri;*
- (d) Respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuar si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit;*
- (e) Mundësi të barabarta;*
- (f) Akses; ..."*

Neni 5 i Konventës, ka përcaktuar se:

- "1. Shtetet Palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.*
- 2. Shtetet Palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimii për shkak të aftësisë së kufizuar dhe t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuar mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në cdo rrethanë.*

3. Me qëllim nxitjen e barazisë dhe eliminimit të diskriminimit, Shtetet Palë duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e duhura për tu siguruar se është ofruar akomodim i arsyeshëm.

4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur de facto barazinë e personave me aftësi të kufizuara nuk do të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj Konvente”.

Në nenin 29, shkronjën a), të Konventës, përcaktohet se:

“Shtetet Palë duhet t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t’i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullsisë dhe duhet të marrin përsipër: a) T’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur...”.

KDPAK përfaqëson standartin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni 1).

Për një kohë të gjatë, personat me aftësi të kufizuara janë parë më shumë si objekte se sa si subjekte të së drejtës, duke evidentuar dhe theksuar paaftësinë/të. Ndërkohë, qasja e re që ofron Konventa “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara” bazohet jo më në modelin e “bamirësisë”, por në atë të të drejtave të njeriut, ku personat me aftësi të kufizuara, si të gjithë qeniet njerëzore, i zotërojnë të drejtat e tyre në mënyrë të pakushtëzuar.

Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuara, por pranon se aftësia e kufizuara është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuara rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambjentit që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët.

Në qendër të vëmendjes nuk është paaftësia e mundshme, por barrierat që vendos shteti apo shoqëria, duke penguar gëzimin e tyre. Barrierat janë të shumëllojshme, ku përveç barrierave fizike, barrierat e ndryshme shoqërore të bazuara në stereotipe, çojnë drejt përjashtimit të personave me aftësi të kufizuara dhe potencialisht mbështesin këtë përjashtim.

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuara. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga Konventa si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Detyrimi i institucioneve publike shtetërore për të siguruar aksesueshmërinë është një detyrim *ex ante*.

Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, parashikon gjithë-përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara.

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Ligji nr. 93/2014, i ndryshuar, ka për qëllim:

- “a) të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes;
- b) të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri”.

Në kuptim të këtij ligji:

- “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve;
- “Pengesë” nënkupton: ...ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.

Parimet bazë të këtij ligji janë:

- a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë;
- b) ç) garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimit të pengesave të të gjitha llojeve.

Jetesa e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, përcakton se, një nga aspektet që siguron jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara është edhe akses në strehim¹⁵.

Në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” parashikohet se:

¹⁵ Neni 5, pika 1, e ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, parashikon: “*Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare*”.

“Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht: a) në strehim të përshtatshëm dhe të jetojnë ku dhe me kë të dëshirojnë....”. Sipas nenit 6, të ligjit nr. 93/2014, jetesa e pavarur, mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave.

VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”,* ka në objekt të saj përcakimin e kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.

Fusha e aplikimit të saj shtrihet në: *“...të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t'i nënshtrohen rikonstruksionit; ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes; ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik”.*

Neni 3, i kësaj VKM, ka përcaktuar se “barrierat arkitektonike” janë:

“1...a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar të përhershme ose të përkohshme;

2. Personat me aftësi të kufizuara (PAK) janë individët, me kufizim të aftësive në lëvizje, si pasojë e dëmtimeve fizike, mendore, intelektuale apo shqisore, të cilët në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.

6. Mjet ndihmës për lëvizje - është karroca për PAK, shkopi, paterica dhe mjete të tjera ndihmëse për ecje;

8. Eliminimi i barrierave - është rezultat i aplikimit të zgjedhjes teknike në projektim dhe ndërtim të objektit me të cilat PAK-ja siguron lëvizjen pa pengesë, qëndrimin dhe kryerjen e punëve në to në të njëjtin nivel sikurse personat e tjerë.

9. Elementet e eliminimit të barrierave - janë pjesë të objekteve ndërtimore ose pajisje, të cilat sigurojnë eliminimin e barrierave, të përcaktuara me këtë rregullore. Këto elemente ose pajisje janë: rampa, shkallë, ashensor, platforma vertikale ngritëse, platforma të pjerrëta lëvizëse palosëse, detaje në hapësirat hyrëse, doreza e derës dhe dritares, pulti, tabela e shpalljeve, plani orientues për lëvizje në ndërtesë, semafori, pajisje komunikimi, hapësira, banja, kuzhine, dhoma, klasa, ambiente pune, banimi/apartamenti, kafeneja, restoranti, gardëroba, kabina dushi, pishina, vendet në tribuna, kabina telefonike, tekstofoni, bankomati, instalimet

elektrike, stacioni dhe peroni, vend parkingu, sipërfaqja publike për këmbësor, kalimi për këmbësor, ishulli për këmbësorë dhe udhëkryqi”.

Në nenin 15, të Kreut II, të kësaj VKM, përcaktohet se:

*“1. Rregullat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për të gjitha llojet e ndërtesave.
2. Në ndërtesat publike duhet garantuar një nivel i arritshmërisë në hapësirat e brendshme i tillë që të mundësojë shfrytëzimin e ndërtesës si nga publiku ashtu edhe nga personeli në shërbim, sipas rregullave të dhëna në nenin 4 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje.
3. Për hapësirat e jashtme që ju përkasin ndërtesave, kushti i domosdoshëm i arritshmërisë quhet i plotësuar nëse ekziston të paktën një rrugë për hyrje në ndërtesë e shfrytëzueshme edhe nga ana e personave me aftësi të kufizuar, përdorues të karrigeve me rrota dhe ndijues”.*

Neni 1, i Pjesës II “Rregullat teknike dhe standardet për garantimin e mundësisë së hyrjes, përshtatshmërisë dhe fushëpamjes në ndërtesa”, ka përcaktuar se këto rregulla aplikohen në: *“...ndërtesat private që ndërtohen të reja, rezidenciale ose jo; ndërtesat rezidenciale publike të financuara nga buxheti i shtetit, që ndërtohen të reja; ristrukturimet e ndërtesave private dhe publike; hapësirat e jashtme të ndërtesave të lartpërmendura në zonat e përcaktuara”.*

VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, në pikën 1, të Kreut I, të saj ka përcaktuar se:

“Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohe pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara”.

3. Janë pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar.

4. Ky vendim e shtrinë zbatimin mbi: a) bashkitë dhe strukturat e tyre të kontrollit, sipërmarrësit privatë, administratorët e bizneseve, kompanitë e projektimit e të zbatimit për të garantuar një mjedis pa pengesa për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara; b) të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kryesisht objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, objektet kulturore, objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët; c) mjetet e transportit publik; ç) mediat dhe tërësinë e mjeteve publike apo private të informimit publik.

5. Standardet e përshtatshmërisë zbatohen në të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore ekzistuese si dhe në parqet, sheshet e rrugët ekzistuese, bazuar në kërkesat e parashikuara në kreun II, të këtij vendimi”.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: c) kontributin dhe mundësinë për të përfutur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfutim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun

3. Ndalohet për një person fizik ose juridik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, të mos pranojë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfutimin e këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuar ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet.

4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohet asnjë arsye si shkak i refuzimit”.

Bazuar në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se:

“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.

Në të njëjtën frymë është dhe ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se:

“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Gjithashtu, referuar Komentit të Përgjithshëm Nr. 6(2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, në lidhje me aksesueshmërinë, ndër të tjera, theksohet që personat me aftësi të kufizuara nuk duhet të jenë ata që të mbajnë kostot dhe barra e provës për të treguar që barra është joproporcionale apo e padrejtë është e ofruesit të shërbimit.

Sa më sipër, “subjekti ankues” duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojnë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹⁶

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtuar nga subjekti ankues, *së pari*, Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e Bashkisë Sarandë, lidhur me mosveprimin e saj për të ndërhyrë dhe zgjidhur problematikën e aksesueshmërisë për në banesën e tij.

Së dyti, Komisioneri, do të vlerësojë nëse ky trajtim i padrejtë, i pafavorshëm i subjektit ankues, nga ana e Bashkisë, lidhet me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës¹⁷, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm nga ana e Bashkisë, në raport me të drejtat dhe lehtësitat e parashikuara drejtpërdrejtë në legjislacionin e sa më sipër analizuar.

Ankuesi ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e Bashkisë, përmes mosofrimit të mundësisë për të aksesuar banesën e tij (ndërtimit të rampës në mënyrë që ai të aksesojë vajtjen deri tek ashensori, për në banesë), megjithëse ligji, subjekt i të cilit janë, ua njeh këtë të drejtë, dhe po ashtu përcakton dhe detyrimin ligjor të shtetit, Bashkisë në këtë rast, për të përmbushur kërkesën e tij.

¹⁶ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁷ Shih Ndarjen III, nëndarja A, të vendimit të KMD.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t'u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëllor si të tjerët, si dhe mundësisht t'u garantohet jetesa e pavarur.

Në kushtet kur shteti, krijon lehtësira të caktuara përmes parashikimeve specifike në akte ligjore apo nënligjore të tij, për kategoritë përfituese të individëve, (përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuar) duhet të sigurohet që t'i ofrojë këto shërbime pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025¹⁸, citon ndër të tjera se:

“Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar (PKVPAK) 2021-2025, është një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara e që do të hidhen për zbatim gjatë 5 vjeçarit të ardhshëm. Qëllimi i tij është të vazhdojë promovimin dhe mbështetjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social-ekonomike të vendit duke patur në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve të KDPAK përmes masave specifike.

Procesi i hartimit të këtij dokumenti përputhet edhe me një moment tjetër të rëndësishëm të zbatimit të politikave për aftësinë e kufizuar në Shqipëri në funksion të realizimit të parimeve të KDPAK, të ratifikuar nga shteti shqiptar.

Qëllimi, objektivat specifike dhe masat e parashikuara në këtë plan për realizimin e aksesueshmërisë, adresojnë reduktimin e barrierave për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim: (i) sigurimin e aksesit në të mirat materiale, shërbimet dhe lehtësirat; (ii) sigurimin dhe mbajtjen e vendit të punës; (iii) përfshirjen dhe pjesëmarrjen në komunitet; (iv) ndryshimet në sjelljet, qëndrimet dhe veprimet, të cilat diskriminojnë personat me aftësi të kufizuara.

Politika orienton institucionet publike në masat që ato duhet të marrin për realizimin e aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në: (i) mjedise; (ii) transport; (iii) informacion e komunikim”.

Ky dokument thekson faktin se, qeveria është e angazhuar të administrojë në mënyrë aktive çështjen e aftësisë së kufizuar në Shqipëri duke përditësuar gjithmonë e më shumë të drejtat e PAK në politikat e saj sektoriale.

Referuar parashikimeve specifike në legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Shqipëria, legjislacionin e brendshëm, si dhe standardet ndërkombëtare dhe kombëtare; barazia dhe mosdiskriminimi i personave me aftësi të kufizuara, duhet kuptuar jo vetëm midis personave me aftësi të kufizuara dhe personave të tjerë, por dhe në raport me të drejtat e tyre ligjore të parashikuara, të njohura dhe të detyrueshem për t'u zbatuar për këtë kategori personash.

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje, analizimit të fakteve, provave të shqyrtuara, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që

¹⁸ Miratuar me VKM Nr. 276, datë 12.05.2021

ankuesi është person me aftësi të kufizuar, i cili lëvizën me karrocë me rrota, atij i është mohuar dhe shkelur e drejta ligjore lidhur me aksesueshmërinë në banesë, masë e cila duhet të ishte marrë nga ana e Bashkisë.

Gjithashtu, nga ana e Bashkisë Sarandë nuk është vënë në dispozicion asnjë informacion apo provë lidhur me hapat e ndërmarrë konkretisht për zgjidhjen e kësaj situatë.

Bazuar në aktet e administruara dhe konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara krijojnë prezumimin se, subjekti ankues, mund të jetë trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të Bashkisë Sarandë, megjithëse posedonte shkakun e mbrojtur nga ligji, atë të aftësisë së kufizuar dhe Bashkia ishte në dijeni të plotë të këtij fakti.

Fakti i posedimit të shkakut të mbrojtur nga ana e subjektit ankues, rezulton i njohur dhe i pranuar nga ana e Bashkisë.

Në këto kushte Bashkia, kishte barrën e provës që të provonte, që megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Mosdiskriminimi është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet. Kjo e drejtë është sanksionuar dhe mbrohet edhe me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar.

Për të qenë përpara një veprimi diskriminues në kuptim të këtij ligji, Komisioneri vlerëson se, duhet të plotësohen tre kushte njëherësh:

- Të ekzistojë trajtimi i diferencuar apo i padrejtë i ankuesit në raport me të tjerët në kushte, rrethana të njëjta apo të ngjashme, apo në raport me të drejtat e tij ligjore;
- Trajtimi i diferencuar të ketë ndodhur për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1, të këtij ligji;
- Trajtimi i diferencuar të ketë sjellë si pasojë vështirësinë apo pamundësinë e ankuesit për të ushtruar të drejtat dhe liritë e njohura nga kushtetuta, aktet ndërkombëtare të ratifikuara apo ligjet e tjera në fuqi.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, në rastin e subjektit ankues përmbushen të tre këto kushte njëherësh dhe se, trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm i subjektit ankues, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se Bashkia Sarandë nuk ka vepruar në bazë të kompetencave, që asaj i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të garantuar aksesin e ankuesit për në banesën e tij, si dhe për rregullimin e situatës në mënyrë efektive dhe përfundimtare.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Bashkia Sarandë, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka diskriminuar subjektin ankues, përse i takon mosmarrjes të masave për zgjidhjen efektive të ankesës së tij, lidhur me realizimin e aksesueshmërisë së lëvizjes së tij për në banesë.

Për rrjedhojë Bashkia Sarandë, ka shkelur dispozitat e ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, respektivisht: nenin 3, pikat 1 dhe 6, dhe nenin 20, pika 1, shkronja a), dhe nenin 4, të tij.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se:

“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”.

Në nenin 33, pika 12, të LMD-së, përcaktohet se:

“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përputhje me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur të subjektit ankues nga ana e Bashkisë Sarandë, dhe kjo mund të realizohet nëpërmjet krijimit të mundësisë që ankuesi të ketë akses për të lëvizur për në banesën e tij, nëpërmjet rampës.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 1, nenin 3, pikat 1 dhe 6, nenin 7, nenin 20 pika 1, shkronja a) dhe pika 4, e tij, nenin 32, shkronja a), si dhe nenin 33, pikat 7/1, 10, 11 dhe 12, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, Z. F, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Sarandë, për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Në referim të pikës 1, Bashkia Sarandë, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të subjektit ankues.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Bashkia Sarandë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime

Shkaku: Aftësia e kufizuar

Lloji i vendimit: Diskriminim